



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency



Ref.:1698/24 Datë: 20.08.2024

Në mbështetje të nenit 11 të Ligjit nr. 08/1-110 për Agjencinë e Kosovës për Akreditim (GZ.nr. 13 / 29 qershor 2023, Prishtinë, nenit 7 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-037 (GZ, Nr.14/9 Shtator 2011), Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative Nr.05/L-031 (GZ.Nr.20/12 Qershor 2016), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.15/2018, datë 28.09.2018), Rregulloren e Punës së Këshillit Shtetëror të Cilësisë, si dhe referuar procesverbalit të mbledhjes së 127 të mbajtur më datë 12.08.2024 Këshilli Shtetëror i Cilësisë, mori:

V E N D I M

- I. Riakreditohet programi i studimit i Fakultetit të Inxhinierisë së Ndërtimit në Universitetin e Prishtinës për periudhën **pesë (5) vjeçare**, (1 tetor 2024 – 30 shtator 2029):
 - *Konstruktiv BSc 180 ECTS R, me kuotën maksimumi 120 studentë për vit akademik;*
- II. Riakreditohen programet e studimeve në Fakultetin e Inxhinierisë së Ndërtimit në Universitetin e Prishtinës për periudhën **tre (3) vjeçare**, (1 tetor 2024 – 30 shtator 2027):
 - *Konstruktiv MSc 120 ECTS R, me kuotën maksimumi 40 studentë për vit akademik;*
 - *Hidroteknikë BSc 180 ECTS R, me kuotën maksimumi 40 studentë për vit akademik;*
- III. Numri i studentëve zbatohet për secilin vit të studimit për periudhën e akreditimit.
- IV. Obligohet Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit në Universitetin e Prishtinës që deri më datë 15.11.2024 të dorëzoj në Agjencinë e Kosovës për Akreditim (tutje AKA) Planin e Implementimit të Rekomandimeve të dhëna nga ekspertët ndërkombëtar të akreditimit.
- V. Obligohet Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit në Universitetin e Prishtinës të raportojë dhe arsyetojë çdo ndryshim në listën e bartësve të programeve të studimit në AKA, brenda 90 ditëve. Ndryshimi i bartësve bëhet vetëm me vendim nga KShC.
- VI. Institucioni i Arsimit të Lartë mban përgjegjësi ligjore për çdo moszbatim apo tejkalim të këtij vendimi.
- VII. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Faqe 1 nga 3

ARSYETIM

Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit në Universitetin e Prishtinës brenda afatit ligjor ka parashtruar kërkesë në Agjencinë e Kosovës për Akreditim, për riakreditimin e programeve të studimeve me stafin akademik si në tabelë:

Nr.	Programi i studimit	Bartësit e programit
1.	<i>Konstruktiv BSc 180 ECTS R</i>	Florim Grajçevci Arton Dautaj Milot Muhaxheri
2.	<i>Konstruktiv MSc 120 ECTS R</i>	Naser Kabashi Hajdar Sadiku
3.	<i>Hidroteknikë BSc 180 ECTS R</i>	Arban Berisha Naim Hasani Fidan Salihu

Me qëllim të vlerësimit të programeve të studimit në Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit në Universitetin e Prishtinës, AKA ka organizuar vizitat me ekspertët ndërkombëtarë të akreditimit: Vizureanu Petrica, Ivana Milicevic, Gabor Dombay dhe Damian Michalik

Bazuar në nenin 17 të UA Nr.15/2018 për akreditimin e IAL-ve, ekipi i vlerësuesve të jashtëm (Ekspertët ndërkombëtar) ka hartuar raportet e vlerësimit për secilin program, dhe për fushat e standardeve të akreditimit të parapara në Manualin e Akreditimit ka dhënë konstatimet si në vijim:

- Për programin e studimit; *Konstruktiv BSc 180 ECTS R***, vizita me ekspertin ndërkombëtar të akreditimit është organizuar më 18.06.2024 të cilët në raport përfundimtar kanë konstatuar se nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: Plotësisht dy (2) kurse Substancialisht pesë (5) fusha të standardeve.
- Për programin e studimit; *Konstruktiv MSc 120 ECTS***, vizita me ekspertin ndërkombëtar të akreditimit është organizuar më 18.06.2024 të cilët në raport përfundimtar kanë konstatuar se nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: Plotësisht dy (2) kurse Substancialisht pesë (5) fusha të standardeve.
- Për programin e studimit; *Hidroteknikë BSc 180 ECTS R***, vizita me ekspertin ndërkombëtar të akreditimit është organizuar më 18.06.2024 të cilët në raport përfundimtar kanë konstatuar se nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: Plotësisht një (1) kurse Substancialisht gjashtë (6) fusha të standardeve.

Për shkak të numrit të vogël të fushave të standardeve të përmbushura plotësisht në vlerësimin e programit *Hidroteknikë BSc 180 ECTS*, KSHC ka vendosur që kohëzgjatja e akreditimit për këtë program të jetë tri (3) vite.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë, në mbledhjen e 127-të, të mbajtur më datë 12.08.2024, ka shqyrtuar dokumentacionin relevant të Fakultetit të Inxhinierisë së Ndërtimit në Universitetin e Prishtinës dhe duke u bazuar në raportet e ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit dhe rekomandimet përfundimtare të dhëna në raportet finale të vlerësimit nga ekspertët e cekur më sipër, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të paraqet ankesë në Komisionin e ankesave, në afatin prej tridhjetë (30) ditësh nga dita kur pala është njoftuar për aktin administrativ. Ankesa adresohet përmes organit publik që ka nxjerrë aktin.

Vendimi iu dërgohet:

- Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit në UP;
- MASHTI;
- Arkivit të AKA-së,




Prof. Asoc. Dr. Hasnija Hazi

Kryetare e Këshillit Shtetëror të Cilësisë